



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria -Vlada-Government**  
**Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice**  
Departamenti për Profesione të Lira-Departmant Slobodnih Profesija- Department of  
Freelance Professions

---

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPL.nr.05/2022

**KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT**, në përbërje nga Manushe Karaçi kryesuese, Adnan Konushevci dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbarduesit privat, në çështjen disiplinore ndaj përmbarduesit privat, \_\_\_\_\_, si organ përmbardues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në \_\_\_\_\_ dhur me veprimet përmbardimore në lëndën përmbardimore, P. nr. 1237/2021, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbardimin Privat, Fadilete Hoxha-Blakqori, pala ankuese \_\_\_\_\_ dhe Përmbarduesi Privat, \_\_\_\_\_ me datën 19.05.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. REFUZOHET** Raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbardimin Privat, DPL-05/2022 i datës 28.02.22, dhe ankesa e paraqitur nga pala ankuese \_\_\_\_\_ e datës 22.02.2022, **e pa bazuar.**

**II. Përmbarduesi Privat** \_\_\_\_\_, si organ përmbardues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në \_\_\_\_\_ **nuk është përgjegjës** për shkelje të pretenduara disiplinore gjatë veprimeve të ndërmarra në lëndën përmbardimore P. nr. 1237/2021.

**A r s y e t i m**

Me datën 22.02.2022, pala ankuese ka paraqitur ankesë në Ministrinë e Drejtësisë ndaj Përmbauesit Privat, pranë të cilës ka mbetur edhe në seancën degjimore, me të cilën pretendon se përmbauesi privat, ka bërë bllokimin e llogarisë me dokumente të gabuara duke vonuar edhe dërgimin e të dhënave të përmirësuara me qëllim të përfitimit në emër të procedurës përmbaimore. Më tej pala ankuese ka theksuar se ka paszuar për obligim 110.00 euro. Fillimisht, i njëjti ka pranuar faturën e obligimit pa nënshkrimin e tij dhe vulën e kompanisë, faturë kjo e cila e obligonte palën ankuese me borxh prej 226.36 euro. Me këtë rast pala ankuese pretendon se i janë rritur shpenzimet nga 110.00 euro në 226.36 euro, duke i shtuar edhe shpenzimet përmbaimore ashtuqë totali i obligimit ka shkuar në 395.25 euro. Për këto arsye i njëjti ka deklaruar se përmbauesi privat ka bërë shkelje disiplinore me rastin e rritjes së këtyre obligimeve dhe i ka propozuar komisionit që të aprovohet ankesa dhe të ndërmerren masa ndaj përmbauesit privat.

Me datën 28.02.2022, Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesionet e Lirë - Divizioni për Noterinë dhe Përmbaimin Privat, ka paraqitur në Komision, Raportin Përfundimtar ndaj përmbauesit privat, lidhur me veprimet përmbaimore për këtë lëndë.

Përmbauesi Privat, si në deklaratën e tij, ashtu edhe në seancën degjimore ka theksuar se kreditori në rastin konkret ka parashtruar propozim për përmbaimit ndaj këtu palës ankuese. Lejimi i Përmbaimit është bërë për borxhin prej 224.05 euro. Sipas fletë kthesave të postës dorëzimi i shkresave është bërë me datë 13.09.2021. Me datën 14.09.2021, përmbauesi privat ka pranuar parashtrësën e kreditorit me të cilën është bërë precizimi i borxhit nga 224.05 euro, në shumën prej 119.12 euro. Pasi debitori nuk ka ushtruar mjet juridik, përmbauesi ka vazhduar me veprimet përmbaimore respektivisht me bllokimin e llogarive bankare të debitorit dhe veprimet tjera përmbaimore, ku debitori e ka përmbushur obligimin në emër të borxhit kryesor dhe shpenzimet përmbaimore përmes deponimit të mjeteve në llogari të veçantë të përmbauesit, pas të cilave veprime ky rast edhe ka përfunduar. I ka propozuar komisionit që ankesa të refuzohet si e pabazuar.

Përfaqësuesja e autorizuar e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesionet e Lirë - Divizioni për Noterinë dhe Përmbaimin Privat, ka bërë shtjellimin e Raportit përfundimtar. Po ashtu edhe pala ankuese si dhe përmbauesi privat, kanë ngelur pranë pretendimeve ankimore, përkatësisht përgjigjes, të paraqitura me shkrim dhe gjatë seancës degjimore.

Pas seancës dëgjimore dhe dëgjimit të palëve, Komisioni Disiplinor me kujdes dhe vëmendje ka vlerësuar në mënyrë shteruese të gjitha pretendimet e palëve dhe ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, dhe pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, erdhi në përfundim që Përmbartuesi Privat, nuk është përgjegjës për shkelje disiplinore.

Komisioni Disiplinor, vlerësoi edhe pretendimin e palës ankuese se i është rritur borxhi me rastin e ekzekutimit-përmbartimit dhe se përmbartuesi qëllimisht ka bërë veprime për ngritje të shpenzimeve përmbartimore.

Për sa i përket rritjes së obligimit, kreditori e ka njoftuar përmbartuesin duke e precizuar obligimin dhe bazuar në obligimin e precizuar pas kalimit të afatit për ushtrim të mjetit juridik nga debitori, përmbartuesi ka marrë veprime përmbartimore të cilat edhe janë llogaritur bazuar në shumën e precizuar. Më këtë rast komisioni vlerësoi se përmbartuesi në fjalë, nuk është përgjegjës për asnjë nga shkeljet e masave disiplinore të përcaktuara me nenin 367 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, ngase të gjitha veprimet përmbartimore për rastin për të cilin është paraqitur ankesa, janë në harmoni me dispozitat e LPP-së.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARTUESIT PRIVAT**

**DPL.nr 05/2022 datë 19.05.2022**

**Kryesuesja e Komisionit Disiplinor**  
**Manushë Karaçi**



***KËSHILLË JURIDIKE:*** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrativ bazuar në nenin 374, par 5 të LPP-së.